



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:080355
Datë: 16.10.2020
Numri i dokumentit: 01193749
P.nr.439/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve B.S nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokatja Adelina Sherifi nga Gjilani, të pandehurit N.Sh nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Amir Daku nga Gjilani dhe të pandehurit B.B nga Gjilani, për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Selami Rexhepi, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.985/2020/2020, të datës 16.07.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 08.10.2020 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 16.10.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1. B .S, nga babai I. dhe nëna Xh, e lindur Sh. , i lindur me datë 20.05.1991, në Gjilan ku dhe jeton rruga lagjja “.....”, numër ..., ka të kryer 2 vite të shkollës së mesme, i pa martuar, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. N.Sh, nga babai I. dhe nëna S., e lindur A., i lindur me datë, në fshatin M....., Komuna e Gjilanit ndërsa me vendbanim në Gjilan, rruga :.....”, numër, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, prona i picerisë “.....” në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
3. B.B, nga babai R. dhe nëna S., e lindur P., i lindur me datë në Gjilan ku dhe jeton në lagjen “.....”, pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

I.

I pandehuri B.S

Me datë....., rreth orës minuta, në rrugën “.....”, në Gjilan, për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme, me dashje ka përdorur forcën ndaj të pandehurit tjetër tani të dëmtuarit N.Sh në atë mënyrë që pas një konflikti verbal në mes vete, i pandehuri shkon i merr dy palë gërshërë tek floktaria “.....”, mjete këto të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe e sulmon duke e goditur në anën e majtë të fytyrës dhe në pjesën e veshit të anës së djathtë të dëmtuarin N.Sh, kështu që i pandehuri me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të pandehurit-këtu të dëmtuarit N.Sh, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

- Me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të KPRK-së.

II.

I pandehuri N. Sh:

Në datën, vendin dhe kohën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme, me dashje ka përdorur forcën ndaj të pandehurit tjetër tani të dëmtuarit B.S, në atë mënyrë që pas një konflikti verbal në mes vete dhe sulmit që i bëhet nga ana e të dëmtuarit i njejt i merr një limë nga i pandehuri tjetër B.B, mjet ky i përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe e sulmon duke e goditur disa herë në pjesën e kokës të dëmtuarin B.S, kështu që i pandehuri me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të pandehurit këtu të dëmtuarit B.S, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilani.

- Me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të KPRK-së.

III.

I pandehuri B.B:

Në datën, vendin dhe kohën si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuze, I pandehuri B. B me dashje e ndihmon të pandehurin N.Sh, duke i vënë në dispozicion mjetin për kryerjen e veprës penale ashtu që me të parë situatën e krijuar, i njejt nga piceria e merr një limë mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe të njëjtën ia jep të pandehurit N.Sh, me të cilën ai e godet në kokë të pandehurin-të dëmtuarin B.S duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e vet e ka ndihmuar të pandehurin N.Sh në kryerjen e veprës penale.

- Me çka ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së

andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 233, 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit e lartcekur:

I GJYKON

Të pandehurin B.S për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe bazuar në nenin 44 të KPRK, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1200 € (njëmijedyqind euro) të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të pandehurin N.Sh për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe bazuar në nenin 44 të KPRK, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1200 € (njëmijedyqind euro) të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe

Të pandehurin B.B për veprën penale nga pika III e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe bazuar në nenin 44 të KPRK, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro) të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të pandehurit e lartcekur nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimet me gjobë atëherë dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen në dënim me burgim për secilin prej tyre veç e veç në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPP-së të pandehurve B.S dhe N.Sh, koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data deri më, do t'iu llogaritet në dënimet e shqiptuara me gjobë për secilin veç e veç.

Bazuar në nenin 115 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i KPP-ës nga i pandehuri B.S KONFISKOHEN dy palë gërsërë si mjete të kryerjes së veprës penale ndërsa nga i pandehuri N.Sh konfiskohet një limë si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohen, të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.07.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.985/2020, kundër të pandehurve B.S nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës, të pandehurit N.Sh nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës dhe të pandehurit B.B nga Gjilani, për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës, ndërsa me datëpranë kësaj gjykate është dorëzuar edhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.nr.985/2020, e datës....., e arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit B.B me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Selami Rexhepi në anën tjetër.

Me datë 08.10.2020, pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit, të pandehurit B.S, N.Sh dhe B.B , mbrojtësit e të pandehurve avokatët Adelina Sherifi, Amir Rudaku dhe Selami Rexhepi. Në këtë seancë është shqyrtuar edhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit B.B me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Selami Rexhepi në anën tjetër, e cila marrëveshje pas dëgjimit të palëve me aktvendim është aprovuar nga ana e gjykatës ndërsa sa i përket të pandehurve B.S dhe N. Sh të njëjtit pas leximit të aktakuzës përkatësisht pikave I dhe II të dispozitivit të saj nga ana e prokurorit të shtetit, secili prej tyre veç e veç kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen secili prej tyre dhe se pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tyre si dhe njoftimit me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, secili prej tyre veç e veç e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila iu vihet në barrë atyre, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve B.S dhe N.Sh.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve të lartcekur për veprat penale për të cilat akuzohen secili prej tyre veç e veç ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tyre nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër 2020-CA-0666, të datës 04.07.2020, raportet e oficerëve policor, raporti i këqyrjes

së vendit të ngjarjes, deklaratat e të pandehurve B.S, N. Sh dhe B.B, deklarata e dëshmitarit G. M, vërtetimi mbi konfiskimin e mjetit me të cilin është kryer vepra penale, raportet mjekësore në emër të të pandehurve B.S dhe N.Sh të datës....., foto dokumentacioni mbi vendin e ngjarjes, ekspertizat mjekoligjore e datës....., në emër të të pandehurve B.S dhe N.Sh si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë gjykata gjeti se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë lidhur me të pandehurin B.B.

Në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata pas dëgjimit të palëve lidhur me marrëveshjen e mbi pranimin e fajësisë të arritur në bazë të nenit 233 paragrafi 21 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen e lartcekur ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 233 paragrafi 18 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur në mes të prokurorit të shtetit në njërin anë si dhe të pandehurit B.B me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Selami Rexhepi në anën tjetër i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale e rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë, siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër 2020-CA-0666, të datës 04.07.2020, raportet e oficerëve policor, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, deklaratat e të pandehurve B.S, N.Sh dhe B.B, deklarata e dëshmitarit G.M, vërtetimi mbi konfiskimin e mjetit me të cilin është kryer vepra penale, raportet mjekësore në emër të të pandehurve B.S dhe N.Sh të datës, foto dokumentacioni mbi vendin e ngjarjes, ekspertizat mjekoligjore e datës, në emër të të pandehurve B.S dhe N.Sh si dhe shkresat e tjera të lëndës, po ashtu gjykata në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- I pandehuri B.S nga Gjilani, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- I pandehuri N.Sh nga Gjilani, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- I pandehuri B.B nga Gjilani, ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-ës në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve të lartcekur secilit prej tyre duhet tu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, këto dënime do të jenë të drejta, në harmoni me peshat e veprave penale dhe përgjegjësinë penale për secilin prej të pandehurve ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së derisa si rrethanë lehtësuese për të pandehurit B.S dhe N.Sh ka marrë faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës penale ndërsa për të pandehurin B. B si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i njejt ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë po ashtu në një fazë të hershme të procedurës penale, po ashtu si rrethë lehtësuese për të gjithë të pandehurit gjykata ka marrë edhe faktin se secili prej të pandehurve janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre duke i kërkuar falje njëri tjetrit në gjykatore, faktin se secili prej tyre kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla e as vepra të tjera penale po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për secilin prej tyre ka marrë edhe rrethanat personale dhe karakterin e tyre ku nga shkresat e lëndës shihet se për të njëjtin është hera e parë që bien ndesh ligjin dhe më parë nuk ka qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo veprave penale, po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dënimeve me gjobë për secilin prej të pandehurve gjykata mori edhe gjendjen e tyre ekonomike ngase sipas deklarimeve të tyre del se të njëjtit janë të gjendjes së mesme ekonomike dhe rrjedhimisht me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi asnjëri prej tyre por as familjarëve të tyre nuk u rrezikohet ekonomike ndërsa rrethanë rënduese për të pandehurit B.S dhe N. Sh gjykata mori shkallën e dëmit të shkaktuar nga veprimet e tyre ngase si pasojë e veprimeve të tyre secili prej tyre kanë pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizat mjekoligjore në emrat e tyre po ashtu si rrethana rënduese për të gjithë të pandehurit gjykata mori edhe shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga secili prej tyre ngase nga shkresat përkatësisht provat e lëndës del se secili prej të pandehurve me dashje kanë kryer veprat penale për të cilat të njëjtit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë gjykata konsideron se këto dënime janë të drejta dhe në harmoni me peshat e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve dhe se me këto dënime mund të arrihen edhe qëllimet e dënimit nga neni 38 të KPRK-së, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Duke pasur parasysh se të pandehurit B.S dhe N.Sh kanë qëndruar nën masën e paraburgimit nga data deri me datë....., gjykata në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës, kohën e kaluar në paraburgim, të njëjtëve ia llogariti në dënimet e shqiptuara me gjobë për secilin prej tyre veç e veç si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata bazuar në nenin 115 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i KPP-ës nga i pandehuri B.S ka konfiskuar dy palë gërrshërë si mjete të kryerjes së veprës penale ndërsa nga i pandehuri N.Sh një limë si mjet i kryerjes së veprës penale.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata në bazë të nenit 451 të KPP-ës ka vendosur që secilin prej të pandehurve veç e veç ti detyrojë të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm,

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.439/2020, me datë 16.10.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.